



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2021:068930

Datë: 07.02.2024

Numri i dokumentit: 05295309

**Ac.nr.1075/2023**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët: Naime Ahmeti kryetare e kolegjit, Liridon Maloku dhe Besnik Bislimaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve A.S., nga fshati K....., D.S., nga fshati Gj....., D.A., nga fshati Gj....., A.K., nga Prizreni, A.M., nga fshati Gj....., B.M., nga fshati T....., M.P., nga fshati K...., G.K. nga fshati Gj....., që të gjithë nga Komuna e Prizrenit, të cilët me autorizim i përfaqësojn B.K., dhe F.G., që të dy avokat nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, të cilën me autorizim e përfaqëson B.M., për kompensimin e shpërblimit jubilar, duke vendosur sipas ankesës të së paditurës, të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.587/2021, të datë 30.01.2023, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 05.02.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** e pathemeltë ankesa e të së paditurës Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, C.nr. 587/2021, të datë 30.01.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me Aktgjykimin e atakuar në dispozitivin I ka vendosur aprovet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësve A.S., nga fshati K....., komuna e Prizrenit, A.K., nga Prizreni, B.M., nga fshati T....., komuna e Prizrenit, M.P., nga fshati K....., Komuna e Prizrenit dhe G.K., nga fshati Gj....., komuna e Prizrenit, detyrohet e paditura, Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, në Prizren, që paditësve ti paguaj shumat si në vijim: Paditësit A.S., nga fshati K....., komuna e Prizrenit, në emër të kompensimit të shpërblimit

jubilar, për 20 vite përvojë pune, ti paguaj 315.75 € apo 75 % të pagës bazë (vlera e pagës bazë 421.00 €). Padihtësit A.K., nga Prizreni, në emër të kompensimit të shpërblimit jubilar, për 30 vite përvojë pune, ti paguaj shumën e përgjithshme prej 421.00 €, apo një pagë bazë (vlera e pagës bazë 421.00 €). Padihtësit B.M., nga fshati T..., komuna e Prizrenit, në emër të kompensimit të shpërblimit jubilar, për 20 vite përvojë pune, ti paguaj shumën e përgjithshme prej 315.75 €, apo 75 % të pagës bazë (vlera e pagës bazë 421.00 €). Padihtëses M.P., nga fshati K..., komuna e Prizrenit, në emër të kompensimit të shpërblimit jubilar, për 30 vite përvojë pune, ti paguaj shumën e përgjithshme prej 421.00 €, apo një pagë bazë (vlera e pagës bazë 421.00 €). Padihtësit G.K., nga Prizreni, në emër të kompensimit të shpërblimit jubilar, për 20 vite përvojë pune, ti paguaj shumën e përgjithshme prej 315.75 €, apo 75 % të pagës bazë (vlera e pagës bazë 421.00 €). Në shumën e përgjithshme prej 1,789.25 €, me kamat ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë me datë 14.04.2021, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm. Në pikën II të dispozitivit pjesa tjetër e kërkesëpadisë përtej shumës së aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, e deri në shumën e kërkuar në lartësi prej 2,501.66 €, në emër të shpërblimit jubilar për padihtësit A.S., A.K., B.M., M.P., dhe G.K., është refuzuar si e pabazuar. Në pikën III të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e padihtësve D.S., nga fshati Gj..., komuna e Prizrenit, D.A., nga fshati Gj..., komuna e Prizrenit dhe A.M., nga fshati T..., komuna e Prizrenit me të cilën kanë kërkuar që “të OBLIGOHET e paditura Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, në Prizren, që padihtësit D.S., për 19 vite përvojë pune ti paguaj kompensimin e 50% të pagës bazë apo shumën prej 515.32 euro, padihtëses D.A., për 29 vite përvojë pune ti paguaj kompensimin e 75% të pagës bazë apo shumën prej 519.10 euro dhe padihtësit A.M., për 22 vite përvojë pune ti paguaj kompensimin e 75% të pagës bazë apo shumën prej 526.28 euro, me kamatë ligjore prej 8%”. Në pikën IV të dispozitivit është detyruar e paditura që padihtësve t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 372.00 €, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura në afatin e paraparë ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën si të bazuar, ta prish aktgjykimin e atakuar dhe të hudhë poshtë padinë e padihtësve, apo aktgjykimin e atakuar ta prish dhe çështjen ta kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- **Ankesa është e pathemltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se padihtësit nëpërmes të autorizuarit, kanë ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizrenit– Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, me të cilën

kanë kërkuar që të detyrohet e paditura që lidhur me kompensimin e shpërblimit jubilar, për vitet jubilarë të paditësve, t'ua paguaj shumat e kërkuara si në precizimin e padisë me datë 09.06.2022, duke llogaritur sipas kamatës ligjore, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Nga ana tjetër e paditura përmes përgjigjes në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve si të pabazuar, lidhur me kompensimin nga marrëdhënia e punës, për shkak të mungesës së linjës buxhetore si dhe për shkak të parashkrimit të kërkesës për shpërblim jubilar.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit paraprak të saj, vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, jashtë shqyrtimit gjyqësor, konform nenit 399 të LPK-së, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar, me të cilin pjesërisht e ka aprovuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjyimit të atakuar.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 dhe paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat janë pretenduar nga pala ankuese.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjyimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjyimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, kjo për arsyeje se me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 të datës 01.11.2010, përcaktohet se *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në mes: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve. Me paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) të nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës. Me paragrafin 4 përcaktohet se Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”*.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, për faktin se nuk është kontestuese se paditësit janë në marrëdhënie pune me të paditurën SH.F.M.U “D..... e K.....”, në K..... në pozitën e mësimitdhënësve, ndërsa

nga provat e bashkangjitura është vërtetuar se: paditësi A.S., pranë të paditurës i ka 20 vite përvojë pune, paditësi A.K., i ka 30 vite përvojë pune, paditësi B.M., i ka 20 vite përvojë pune, paditësja M.P., i ka 30 vite përvojë pune dhe paditësi G.K., i ka 20 vite përvojë pune, fakt i vërtetuar përmes vërtetimeve të lëshuara nga e paditura me datë 26.02.2021, nga të cilat vërtetime po ashtu është vërtetuar paga bruto dhe neto e tyre.

Gjithashtu, bazuar në nenin 35 paragrafin 8, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 përcaktohet se: *“Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë: pika 8.1. për 10 vjet të përvojës së punës në vlerë të 50% të një page bazë, pika 8.2. për 20 vjet të përvojës së punës në vlerë të 75% të një page bazë, pika 8.3. për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë, ndërsa pika 8.5. përcakton se: Shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi, kur i punësuari ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kriterëve përkatëse, 8.6. Shpërblimi jubilar paguhet në rastin e 7 Marsit të çdo viti ”*, e duke marrë parasysh se nga administrimi i provave nga ana e gjykatës së shkallës së parë, u vërtetua përvoja e punës së tyre si dhe të ardhurat neto të cilat i pranojnë, atëherë konform nenit të lartcekur, konkludohet se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur edhe me rastin e aprovimit të kërkesëpadsisë së paditësve, A.S., A.K., B.M., M.P., dhe G.K., lidhur me kompensimin e shpërblimit jubilar, siç shihet më decidivisht është vendosur në dispozitivin I të aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadsisë së paditëses, duke vendosur decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, me të drejtë është bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, të lidhur dhe nënshkruar nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK-ut) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës (MASHT), e cila kontratë ka qenë në fuqi me rastin e lindjes të së drejtës për të parashtruar kërkesën për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë, që nënkupton se kjo Kontratë shërben si akt nga i cili buron themelësia e kërkesëpadsisë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditëses se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadsisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Kolegji i Gjykatës së Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur ka aprovuar pjesërisht si të pabazuar kërkesëpadsinë e paditësve, sepse nga shkresat e lëndës është konstatuar se paditësi A.S., i ka për 20 vite përvojë pune, Avdi Kabashi 30 vite përvojë, B.M., 20 vite përvojë pune dhe M.P., 30 vite përvojë pune, ndërsa lidhur me lartësinë ka vendosur në bazë të vërtetimeve të lëshuara nga vet e paditura nga shihet paga neto e secilit paditës.

Vendimi mbi kamatën e përcaktuar është në përputhje me dispozitën e nenit 382 të LMD-së, ndërsa vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitën nga neni 452.1 të LPK-së, ndërsa veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese janë arsyetuar drejtë, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragrafi 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.1075/2023, me datë 05.02.2024**

**Kryetare e Kolegjit**  
**Naime Ahmeti d.v**